

VENDIM
Nr. 865, datë 21.10.2015

**PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK “PËR ETIKETIMIN E ENERGJISË PËR
KONDITIONERËT E AJRIT”¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 68/2012, “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullit teknik “Për etiketimin e energjisë për kondicionerët e ajrit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

¹ Projektvendimi është në përputhje të plotë me Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, nr. 626/2011, datë 4 maj 2011 “Për etiketimin e energjisë për kondicionerët e ajrit”, Nuri EUR-Lex-32011R32011RO626-EN, Fletore zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L 178/1, e amenduar nga Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, nr. 518/2014, datë 5 mars 2014, që amendon rregulloret e lidhura me informacionin për etiketimin e energjisë që sigurohet nëpërmjet internetit.